

LIGA UNIKE | SHQIPËRI-KOSOVË



**LIGA
UNIKE**

RREGULLORJA E GARAVE

EDICIONI 2022/2023

PËRMBAJTA

- I. Dispozitat Themelore;
- II. Funksionimi i Ligës;
- III. Sistemi i Garave;
- IV. Kalendarit, ditët dhe koha e zhvillimit të ndeshjeve;
- V. Klubet dhe Palestrat e Sporteve;
- VI. Lojtarët-Trajnerët;
- VII. Ndeshjet;
- VIII. Komesari i Garave dhe Personat Zyrtarë;
- IX. Marketingu i Ligës Unike;
- X. Obligimet e Klubeve;
- XI – XVIII. Dënimet dhe Ankesat;
- XIX. Forca Madhore;
- XX. Miratimi dhe plotësimi i Rregullores së Garave.

Bordi Drejtues i Ligës Unike Konform Nenit 1, pika 1.2 të Statutit, dhe me propozim të Komesarit të Garave miraton:

Rregulloren e Garave

Edicioni 2022-2023

Neni 1: Dispozitat Themelore

1.1 Ligën Unike e përbëjnë klubet nga Shqipëria dhe Kosova, detyra e të cilave është vazhdimi i traditës, si dhe ngritja e cilësisë së lojës të basketbollit. Liga Unike funksionon nën ombrellën e Federatës së Basketbollit të Shqipërisë (FSHB) dhe Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK).

1.2 Federata Shqiptare e Basketbollit dhe Federata e Basketbollit e Kosovës delegojnë nga katër (4) ekipe për pjesëmarrje në Ligën Unike në konkurrencën e meshkujve dhe nga tri (3) ekipe në konkurrencën e femrave.

Për edicionin 2022-2023 në konkurrencën e meshkujve të nominuara janë këto skuadra: Golden Eagle Ylli, Ponte Prizreni, Trepça dhe Peja nga Kosova, si dhe Vllaznia, Tirana, Teuta dhe Kamza nga Shqipëria. Në konkurrencën e femrave, nga Kosova janë të nominuara këto skuadra: Penza, Bashkimi dhe Prishtina, ndërsa nga Shqipëria: Flamurtari, Partizani dhe Tirana.

1.3 Federatat pjesëmarrëse delegojnë ekipet më të mira të renditura në edicionin paraprak për pjesëmarrje në Ligën Unike. Në rast se ekipet më të mira nga edicioni paraprak (kampioni, nënkampioni, fituesi i Kupës) marrin pjesë në garat evropiane, duhet të ripunohet kalendari i garave ose të ftohen të renditurit në tabelë sipas radhës.

1.4 Liga Unike mbikëqyret nga Bordi Drejtues i Ligës, në të cilin të gjitha federatat pjesëmarrëse i delegojnë nga 2 përfaqësues, ndërsa përfaqësuesit e federatave në këtë bord e emërojnë unanimisht anëtarin e pavarur të Bordit, i cili do të shërbejë edhe si Kryetar i Bordit Drejtues të Ligës.

1.5 Liga Unike punëson (angazhon) persona për vitin fiskal 2022/23 nga të dy Federatat themeluese të Ligës, FSHB dhe FBK. Të dy Federatat janë përgjegjëse për emërimin e këtyre personave para fillimit të edicionit 2022/23.

1.6 Komesari i Garave (nga FBK dhe në koordinim me personin përgjegjës për personat zyrtarë nga FSHB) nominon të gjithë personat zyrtarë (gjqqtarët, vëzhguesin dhe vlerësuesin e gjyqtarëve) në marrëveshje me Federatat respektive, FSHB dhe FBK dhe shqipton dënimet sipas Rregullores së Garave.

Bordi i Ligës Unike është përgjegjës për vendimet e Komesarit të Garave, dhe personave të emëruar nga të dyja Federatat themeluese të ligës.

1.7 Të gjitha klubet pjesëmarrëse në Ligën Unike janë të obliguara që të lexojnë këtë Rregullore të Garave dhe të bashkëpunojnë me të gjitha organet e Ligës Unike.

1.8 Klubet pjesëmarrëse në Ligën Unike në asnjë rrethanë nuk guxojnë në asnjë mënyrë të refuzojnë ndeshjen, të lëshojnë fushën e lojës pa përfunduar ndeshja.

1.9 Klubet pjesëmarrëse në Ligën Unike në asnjë mënyrë nuk guxojnë të refuzojnë-largohen nga ceremonia e mbylljes, ndarjes së mirënjohjeve, medaljeve dhe Kupave pas përfundimit të ndeshjes finale.

1.10 Liga Unike krijohet si entitet i posaçëm në bazë të ligjeve të Kosovës dhe ka selinë e vet.

1.11 Liga Unike ka të drejtën ekskluzive mediale për transmetimin e ndeshjeve si në Kosovë/Shqipëri dhe kjo është e detajuar në rregulloren e marketingut.

Neni 2: Funkionimi i Ligës Unike

2.1 Ndeshjet në Ligën Unike do të zhvillohen në përputhje me Rregullat zyrtare të basketbollit të aprovuara nga Federata Ndërkombëtare e Basketbollit (FIBA).

2.2 Mënyra e pagesave si dhe afatet e pagesave në kuadër të Ligës Unike definoohen nga Bordi Drejtues.

2.2.1 Klubi i cili nuk kryen obligimet ose obligimet tjera (dënimet e shqiptuara) ndaj Ligës Unike nga edicioni paraprak, nuk mund të jetë pjesë e Ligës në edicionin tjetër.

2.3 Kostoja për organizimin e Ligës Unike bartet nga Federatat pjesëmarrëse dhe nga sponsorët e Ligës.

2.4 Të gjitha shpenzimet e personave zyrtarë (nominimin e gjyqtarëve, vëzhguesve, vlerësuesin e gjyqtarëve) dhe mbikëqyrjes së punës së tyre barten nga Liga Unike (Federatat pjesëmarrëse).

2.5 Në konkurrencën e meshkujve Liga Unike do të ofrojë shpërblime për dy gjysmëfinalistët nga 3.000€, për finalistët nga 5.000€ dhe për klubin i cili shpallet Kampion i Ligës Unike do të ndahen 9.000€ (25.000€ gjithsej).

2.6 Fituesi i Superkupës Mbarëkombëtare do të shpërblehet me 5.000 €.

2.7 Në konkurrencën e femrave Liga Unike do të ofrojë shpërblime për dy gjysmëfinalistët nga 1.500€, për finalistët nga 3.000€ dhe për klubin i cili shpallet Kampion i Ligës Unike do të ndahen 6.000€ (15.000€ gjithsej).

2.8 Fituesi i Superkupës Mbarëkombëtare në konkurrencën e femrave Liga Unike do të shpërblehet me 3.000 €.

Neni 3: Sistemi i Garave

3.1 Në konkurrencën e meshkujve Liga Unike do të zhvillohet me sistem vajtje-ardhje në edicionin 2022-2023.

3.2 Pas përfundimit të 14 xhirove të rregullta (56 ndeshje) vendet 1- 4 kualifikohen direkt për Final 4, ku në gjysmëfinale takohen 1-4 dhe 2-3. Kampion shpallet ekipi i cili fiton në finalen e Final 4. Para ndeshjes finale zhvillohet edhe ndeshja për vendin 3-4.

3.3 Në konkurrencën e femrave Liga Unike do të zhvillohet me sistem vajtje-ardhje në edicionin 2022-2023.

3.4 Pas përfundimit të 10 xhirove të rregullta (30 ndeshje) në konkurrencën e femrave, vendet 1-4 kualifikohen direkt për Final 4, ku në gjysmëfinale takohen 1-4 dhe 2-3. Kampion shpallet ekipi i cili fiton në finalen e Final 4. Para ndeshjes finale zhvillohet edhe ndeshja për vendin 3-4.

3.4 Final 4 organizohet me rotacion mes federatave pjesëmarrëse, nën kushtet e Udhëzuesit për Organizimin e Final 4 të Ligës Unike.

3.5 Para edicionit 2022-2023 dhe vitet vijuese do të organizohet Superkupa Mbarëkombëtare në të cilën luajnë Kampioni dhe Fituesi i Kupës së dy kampionateve në të dyja konkurrencat.

3.6 Superkupa Mbarëkombëtare për meshkuj dhe femra do të organizohet në Kosovë nga Federata e Basketbollit e Kosovës dhe Final 4 i Ligës për meshkuj dhe femra do të organizohet në Shqipëri nga Federata Shqiptare e Basketbollit (FSHB).

Neni 4: Kalendari, ditët dhe koha e zhvillimit të ndeshjeve

4.1 Kalendarin e Garave, të gjitha ndryshimet, plotësimet në të gjitha nivelet, i plotëson Bordi Drejtues me propozim të Komesarit të Garave.

4.2 Kalendari i Garave nuk mund të ndryshohet dhe ndeshjet duhet të zhvillohen sipas orarit të ndeshjeve të aprovuara nga Bordi Drejtues.

4.3 Nëse ndeshja e planifikuar nuk mund të zhvillohet për arsye të pa planifikuara (moti i keq, tërmeti, vërshimet) brenda 24 orëve nga data e planifikuar për fillimin e ndeshjes, ajo do të shtyhet.

4.4 Vendimi për terminin e ri të ndeshjes do ta bëjë Komesari i Garave dhe ndeshja duhet të zhvillohet para përfundimit të edicionit të rregullt.

4.5 Nëse vjen deri te ndërprerja e ndeshjes e cila është duke u zhvilluar për arsye të pa planifikuar (problemet e ndryshme teknike) do të vazhdojë ashtu, që do të merret parasysh koha dhe rezultati të ndërprerja e ndeshjes. Ndeshja duhet të vazhdojë brenda 24 orëve të ardhshme.

4.6 Ndeshjet do të zhvillohen në mes jave sipas orarit e mërkurë dhe e enjte, nga ora 17:00 dhe 19:00 në konkurrencën e meshkujve, kurse e martë-e enjte në konkurrencën e femrave nga ora 17:00 dhe 19:00.

4.7 Të gjitha ndeshjet e Ligës Unike do të zhvillohen sipas kalendarit të aprovuar, por Bordi Drejtues mund të ndryshon terminet e zhvillimit të ndeshjeve nëse ajo është në interes të Ligës Unike.

Neni 5: Klubet dhe palestrat sportive

5.1 Çdo klub është i obliguar që më së largu 14 ditë para fillimit të garave të paraqesë palestrën dhe palestrën alternative në të cilën do t'i zhvillojë ndeshjet.

5.2 Klubet në garat e Ligës Unike do të prezantohen me emrin e tyre zyrtar, gjegjësisht nën emrin e tyre regjistruar.

5.3 Klubi organizator është i obliguar të ofrojë 16 ulëse në bankinat për ekipin mysafir, ku mund të qëndrojnë zëvendësuesit, trajnerët, mjeku, fizioterapeuti dhe përfaqësuesit zyrtarë, por nuk mund të kalojnë numrin prej 9 personave. Në bankinat e klubeve, të drejtë kanë vetëm personat zyrtarë të regjistruar në Listën Paraqitëse ose MAP të Federatave Nacionale.

5.4 Klubi organizator në ndeshjet e Ligës Unike është i obliguar të paraqesë forca të mjaftueshme të sigurisë (Polic dhe Sigurim Privat), varësisht nga numri i shikuesve.

5.5 Klubi organizator është i obliguar të organizojë tavolinën zyrtare duke u ofruar kushte personave zyrtarë, si dhe të paraqesë mjetet teknike të punës.

5.6 Në rast të prishjes së pajisjeve teknike, ndeshja mund të vazhdojë edhe me pajisjet ndihmëse nëse arrihet marrëveshja mes klubeve.

5.7 Klubi organizator është i obliguar të organizojë dhe të mbajë në mënyrë kompjuterike STATS Live duke ofruar 2 mbajtës të statistikave, ku njëri duhet të posedojë FIBA Stats Licencën valide.

5.8 Mos mbajtja e STATS Live do të sanksionohet konform rregullores së garave. Klubi është i obliguar të ofrojë laptopin, si dhe printerin për printimin e statistikave gjatë përfundimit të çdo çereku duke i ofruar ekipeve nga dy kopje.

5.9 Programi i mbajtjes së statistikave duhet të jetë në gjuhën angleze.

5.10 Klubi organizator është i obliguar që pas ndeshjes t'i ofrojë statistikën vëzhguesit të ndeshjes, kurse mbajtësi i statistikave LIVE t'i dërgojë menjëherë pas përfundimit të ndeshjes Komesarit të Garave në postën elektronike.

5.11 Klubi organizator është i obliguar të ofrojë zërimin për prezantimin e klubeve dhe të personave tjerë zyrtarë dhe i njëjti nuk guxon të përdoret për anim, gjatë zhvillimit të ndeshjes, si dhe komentimin e ndarjes së drejtësisë.

5.12 Së pari (në 9 minuta e mbetur të intervalit) bëhet prezantimi i lojtarëve, trajnerëve të skuadrës mysafire, pastaj skuadrës vendase dhe personave zyrtarë (gjyqtarët/vëzhguesi) si dhe interpretimi i himneve të dy shteteve. Mosrespektimi i këtij neni do të sanksionohet konform Rregullores së Garave.

5.13 Klubi organizator gjatë zhvillimit të ndeshjes është i obliguar të sigurojë prezencën e mjekut kujdestar në palestër.

5.14 Klubi organizator bartë përgjegjësinë për të gjitha incidentet e mundshme para, gjatë dhe pas përfundimit të ndeshjes dhe i njëjti do të sanksionohet konform Rregullores së Garave.

5.15 Klubi organizator bartë përgjegjësinë për sjelljet jospportive të shikuesve dhe hedhjet e gjësendeve të buta, të forta, si dhe të fishekzjarrëve në fushë.

5.16 Klubi organizator bartë përgjegjësinë për sjelljet jo sportive të shikuesve (ofendime racore) dhe paraqitja e pankartave ofenduese.

5.1.1 Temperatura në palestrat e sporteve gjatë zhvillimit të ndeshjes nuk guxon të jetë nën 16° C.

5.1.2 Të gjitha ndeshjet mund të zhvillohen vetëm në palestrat të cilat i mbushin kushtet e parapara me rregullat zyrtare të basketbollit.

5.1.3 Në të gjitha palestrat në të cilën zhvillohen ndeshjet e Ligës Unike duhet të jetë instaluar interneti me më së paku 30/10 mbps shpejtësi.

5.1.4 Të gjitha palestrat duhet të jenë të pajisura me aparaturat teknike sipas FIBA Equipment 2022 semafori i ndeshjes, display i kohës së sulmit prej 24 sekondave.

5.1.5 Në palestrat ku zhvillohen ndeshjet e Ligës Unike në tabelat e konstruksionit duhet të jenë LED ndriçimet të aprovuara nga FIBA Equipment 2018 për sinjalizimin e përfundimit të kohës së sulmit dhe kohës së ndeshjes.

5.1.6 Kur tabelat janë të pajisura me LED ndriçimin konform FIBA Equipment 2018, ky ndriçim ka përparësi në raport nga sinjali i zërit të kohës së lojës.

5.1.7 Fusha e lojës duhet të jetë me dimensione 28X15, sipas rregullave zyrtare të basketbollit me hapësirën prej 2m rreth fushës së lojës.

Neni 6: Lojtarët

6.1 Të gjithë lojtarët e një klubi duhet të kenë uniformën e njëjtë.

6.2 Nuk lejohet bartja e asnjë fanelle apo pajisje tjetër përveç me rekomandim të mjekut. Rekomandimi i mjekut para ndeshjes duhet t'i paraqitet vëzhguesit.

6.3 Skuadra vendase është e obliguar të paraqitet me uniformë ngjyrë të ndritshme, kurse skuadra mysafire me uniformë ngjyrë të mbylltë.

6.4 Klubet pjesëmarrëse në Ligën Unike u nënshtrohen rregullave të Federatave Nacionale rreth regjistrimit dhe paraqitjes në fushën e lojës të lojtarëve/eve në edicionin 2022/23.

6.5 Regjistrimin e lojtarëve e kryejnë Federatat Nacionale dhe listën me më së shumti 18 lojtarë seniorë dhe të përfaqësuesve zyrtarë duhet të dërgohet në Ligën Unike më së paku 72 orë para zhvillimit të ndeshjes së xhiros së parë.

6.6 Regjistrimi i lojtarëve përfundon sipas afateve të përcaktuara nga Federatat nacionale.

6.7 Klubet pjesëmarrëse në Ligën Unike u nënshtrohen rregullave të Federatave nacionale rreth regjistrimit të lojtarëve të huaj si dhe të drejtës së paraqitjes së tyre nga Ligat Nacionale.

6.8 Detyrën e trajnerit apo të ndihmës trajnerit kanë të drejtë të kryejnë vetëm trajnerët e licencuar nga Federatat Nacionale.

6.9 Vetëm trajnerit dhe ndihmës trajnerit i lejohet të qëndrojnë në këmbë dhe të komunikojë me lojtarët, por gjithmonë duke qëndruar në hapësirat e kufizuara.

6.10 Trajneri dhe personat tjerë zyrtarë të ekipit janë të obliguar që të jenë të veshur me veshje zyrtare (sako, këmishë, pantallona dhe këpucë).

Neni 7: Ndeshjet

7.1 Ndeshjet që zhvillohen në kuadër të Ligës Unike në mes ekipeve pjesëmarrëse të Federatave Nationale do të administrohen nga Liga Unike, ndërsa integrohen edhe në ligat nacionale. Do të thotë rezultati i ndeshjes Golden Eagle Ylli vs Trepça në Ligën Unike do të regjistrohet si i tillë edhe në Prince Caffè Superligë (në raundin e II dhe III). Në këto ndeshje të Ligës Unike vlejné rregullat e kampionateve nacionale.

7.2 Shorti për zhvillimin e ndeshjeve të Ligës Unike do të jetë gjysmë i dirigjuar, në mënyrë që për çdo xhiro të zhvillohen nga dy ndeshje në Shqipëri dhe dy ndeshje në Kosovë.

7.3 Ndeshjet do të jenë të transmetuara me ekip të plotë televiziv OBV dhe gjyqtarët në ato ndeshje do të kenë mundësi të rishikojné situatat, ku konform FIBA Rregullave të Basketbollit mund të përdorin IRS dhe do organizohen në nivel të garave rajonale.

7.4 Të gjitha ndeshjet e Ligës Unike të cilat zhvillohen në Kosovë luhen me topa konform Rregullores së Garave të FBK-së, kurse ndeshjet të cilat zhvillohen në Shqipëri me topat konform Rregullores së Garave të FSHB-së.

7.4 Klubi i cili pa arsye nuk paraqitet në terminin e cekur më herët për zhvillimin e ndeshjes, ndeshjen e humb me rezultat zyrtar 20:0 dhe nuk merr asnjë pikë.

7.5 Klubi i cili humb dy ndeshje me rezultat zyrtar do të largohet nga Liga Unike dhe në edicionin e ardhshëm nuk i lejohet pjesëmarrja në Ligë.

7.6 Klubi i cili braktisë në mënyrë arbitrare fushën e lojës dhe nuk kthehet për vazhdimin e ndeshjes pas kohës shpenzimit së kohë Time Out-it të mbetur në atë periudhë dhe pas ftesës së gjyqtarëve, do të largohet nga garat e mëtutjeshme dhe në edicionin e ardhshëm nuk i lejohet pjesëmarrja në Ligë.

Neni 8: Komesari i Garave & Personat Zvrtarë

8.1 Organi themelor që udhëheq me gara është Komesari i Garave, i cili emërohet nga Bordi Drejtues me propozimin e dy Federatave (Komesari i Garave në FBK, është ai që koordinohet për çdo gjë me personin përgjegjës nga FSHB, për zyrtarët e ndeshjeve).

8.2 Duke udhëhequr me garat Komesari i Garave do t'i zbatojë këto Rregullore të Garave dhe aktet tjera të FIBA-s.

8.3 Komesari i Garave bënë nominimin e personave zyrtarë në marrëveshje me Federatat Nationale, regjistron ndeshjet e zhvilluara dhe paraqet dënimet sipas rregullores së garave.

8.4 Të dy Federatat Nacionale në Ligën Unike paraqesin vëzhgues dhe gjyqtarët nga Listat A dhe B të tyre për të ndarë drejtësinë në Ligën Unike. Federatat do t'i paraqesin gjyqtarët dhe vëzhguesit më të mirë dhe të njëjtit do t'u nënshtrohen testeve para fillimit të edicionit në Federatat Nacionale.

8.5 Komesari i Garave bënë nominimin në mënyrë autonome, por në bazë të formulës vijuese: në çdo ndeshje duhet të nominohen dy zyrtarë nga FSHB-ja dhe dy nga FBK-ja.

8.6 Kur ndeshjet në konkurrencën e meshkujve zhvillohen në Shqipëri në mes ekipeve të FSHB dhe FBK-se, vëzhguesi dhe një gjyqtar nominohen nga lista e FSHB-së, ndërsa dy gjyqtarë nominohen nga lista e FBK-së. Kur ndeshja zhvillohet në Kosovë, vëzhguesi dhe një gjyqtarë nominohen nga lista e FBK-së, ndërsa dy gjyqtarë nominohen nga lista e FSHB-së. Në ndeshjet e Final 4 nominimi i gjyqtarëve do të jetë konform performancës së gjyqtarëve.

8.6.1 Në ndeshjet e Liga Unike Femrat nominimet e gjyqtarëve-vëzhguesi do të jenë nga Federatat Nacionale, përveç kur për shkak të mbarëvajtjes së rregullt do të jetë i domosdoshëm nominimi i gjyqtarëve nga dy Federatat Nacionale. Në ndeshjet e Final 4 nominimi gjyqtarëve do të jetë konform performancës së gjyqtarëve.

8.7 Komesari i Garave nominimin e personave zyrtarë do ta bëjë me anë të postës elektronike më së paku 72 orë para zhvillimit të ndeshjes, ku gjyqtarët duhet të konfirmojnë nominimin në ndeshjet e Ligës Unike.

8.8 Komesari i Garave i fton në përgjegjësi dhe ndëshkon në shkallë të parë gjyqtarët të cilët nuk i respektojnë dispozitat e rregullave të basketbollit dhe nuk kryejnë detyrat e tyre konform Rregullores së Garave.

8.9 Komesari i Garave është i obliguar që pas çdo xhiro të zhvilluar brenda 48 orëve të ardhshme të publikojë Informatorin e xhiros, ku publikohen rezultatet dhe masat e shqiptuara konform rregullores së garave dhe i njëjti bëhet publik në uebfaqen e Ligës Unike.

Vlerësuesi i gjyqtarëve:

8.9.1 Vlerësuesi i gjyqtarëve nominohet në shtetin në të cilin zhvillohet ndeshja e Ligës Unike dhe është pjesëmarrës në Pre Game/Post Game dhe bënë evoluimin e gjyqtarëve.

8.9.2 Vlerësuesi i gjyqtarëve brenda periudhës sa më të shkurtër, ka obligim të dërgojë video klipet nga ndeshja e fundit si dhe kërkon evoluimin e klipeve nga gjyqtarët.

8.9.3 Vlerësuesit janë të obliguar që raportin për gjyqtarë t'ia dërgojnë Komesarit të Garave dhe Bordit Drejtues.

Gjyqtarët:

Neni 8.9.4 Gjyqtarët e nominuar në ndeshjet e Ligës Unike janë të obliguar që të paraqiten me kollare dhe të respektojnë kodin e veshjes.

Neni 8.9.5 Gjyqtari i parë është përgjegjës për marrjen e masave ndaj sjelljeve jospportive të shikuesve, hedhjet e gjësendeve, ofendimet racore dhe atë:

- ***Duke njoftuar shikuesit me anë të spikerit***
- ***Zbrazjen e një pjese të palestrës***
- ***Ndërprerjen e ndeshjes (në raste të rënda)***

8.9.6 Gjyqtarët janë plotësisht të pavarur në vendim marrje, duke respektuar FIBA Rregullat zyrtare të Basketbollit, interpretimet e rregullave, si dhe rregulloren e garave.

8.9.6./1 Gjyqtari kryesor ka të drejtë të marrë vendime në të gjitha rastet kur ato nuk janë të rregulluara nga FIBA Rregullat e Basketbollit, si dhe rregullores së garave.

8.9.7 Gjyqtarët janë të obliguar të paraqiten në palestrën e sporteve ku zhvillohet ndeshja 75 minuta para fillimit të ndeshjes, kurse gjyqtarët ndihmës 45 minuta.

8.9.8 Nuk lejohet që gjyqtarët gjatë gjykimit të ndeshjes të paraqiten me uniforma të ndryshme.

8.9.9 Gjyqtarëve nuk i lejohet udhëtimi me klubet, në ndeshjet e të cilave ata janë të nominuar.

8.9.10 Gjyqtarët pas përfundimit të ndeshjes mund të largohen vetëm pasi janë lejuar nga vëzhguesi dhe pas përfundimit të Post Game.

Vëzhguesi:

8.9.11 Vëzhguesit e nominuar në ndeshjet e Ligës Unike janë të obliguar që të paraqiten me kollare dhe të respektojnë kodin e veshjes.

8.9.12 Vëzhguesit nominohen në ndeshje për të siguruar rrjedhën normale të saj dhe është i obliguar të bashkëpunojë me gjyqtarët para, gjatë dhe pas ndeshjes.

8.9.13 Vëzhguesit janë përgjegjës për punën dhe funksionimin e gjyqtarëve ndihmës, si dhe kontrollon MAP-in e ekipeve, si dhe dokumentacionet tjera.

8.9.14 Vëzhguesit në raportin e ndeshjes janë të obliguar të paraqesin të dhënat nga organizimi ndeshjes dhe për rastet kontestuese në raportin e ndeshjes së bashku me protokollin e ndeshjes dhe listat paraqitëse duhet t'i dërgojë në adresën elektronike brenda 24 orëve të ardhshme.

8.9.15 Në rast ankese vëzhguesi i ndeshjes është i obliguar brenda 1 ore pas përfundimit të ndeshjes në adresën elektronike të dërgojë:

- ***Ankesën në formë shkrimi***
 - ***Protokollin e ndeshjes (i nënshkruar nga kapiteni)***
-

- Deklaratat e personave zyrtarë për ngjarjen kontestuese
- Raportin e ndeshjes

8.9.16 Vëzhguesi në bashkëpunim me gjyqtarët e ndeshjes janë të obliguar të respektojnë Nenin E.1 nga Rregullat e Basketbollit për shfrytëzimin e Time Out-it medial në kohë prej 60 sekonda. Time Out ky i ndarë enkas për marketing të Ligës. Hapësira mediatike/reklamuese tjetër gjatë ndeshjes do të ndahet sipas formulës 50% për ekipin vendas, 25% për ekipin mysafir dhe 25% për Ligën.

8.9.17 Në çdo çerek është e lejuar një media Time Out, përkundër Time Out-it të rregullt. Media Time Out nuk lejohet në vazhdim të ndeshjes (over time).

8.9.18 Media Time Out-it do t'i ndahet ekipeve para se të mbeten 5 minutat e fundit të çerekut.

8.9.19 Nëse asnjëra ekip nuk kërkon Time Out para se të mbeten 5 minutat e fundit, atëherë Media Time Out do t'i ndahet ne rastin e parë kur topi do të bëhet i vdekur dhe koha e lojës është ndalur.

8.9.20 Nëse njërit ekip do t'i ndahet një Time Out para se të mbeten 5 minutat e çerekut, ky Time Out do të llogaritet si Media Time Out.

8.9.21 Tarifat e personavë zyrtarë të ndeshjeve përcaktohen me vendim të Bordit Drejtues të Ligës Unike.

Neni 9: Marketingu i Ligës Unike

9.1 Organizatori i ndeshjes duhet të sigurojë vendin reklamave të sponsorëve të Ligës Unike.

9.2 Vendorsja e reklamave do të bëhet sipas kontratave që ka Liga Unike me sponsorët e saj.

9.3 Organizatori është përgjegjës dhe i nënshtrohet sanksioneve për mos respektimin e dispozitave të marrëveshjes me sponsorë.

9.4 Vendorsja e reklamave të sponsorit gjeneral të Ligës Unike do të përcaktohet me një rregullore për marketing në ndeshjet e organizuara nga Liga Unike, që do të miratohet nga Bordi Drejtues i Ligës Unike dhe do të konsiderohet pjesë përbërëse e kësaj rregullore të garave.

Neni 10: Obligimet e klubeve

10.1 Klubet pjesëmarrëse në edicionin 2022/2023 janë të liruara nga kootizimi për pjesëmarrje në Ligën Unike.

10.3 Klubet pjesëmarrëse në Ligën Unike janë të obliguara t'i mbulojnë kostot e gjyqtarëve ndihmës për punën në tavolinën zyrtare dhe për mbajtësit e Live Stats.

10.4 Dënimet mandatare të shqiptuara nga Komesari i Garave, klubet janë të obliguara të paguajnë deri 48 orë para zhvillimit të ndeshjes së radhës.

Neni 11: Dënimet

11.1 Komesari i Garave, organi i shkallës së parë ka autorizim për shqiptimin e dënimeve të gjyqtarëve, vëzhguesve, klubeve, lojtarëve dhe personave tjerë zyrtarë të cilët në ndeshje nuk sillen në frymën sportive duke shkelur Rregulloren e Garave të Ligës Unike.

11.2 Ndaj dënimeve mandatare të shqiptuara nga Komesari i Garave, klubeve pjesëmarrëse në Ligën Unike nuk ju lejohet parashtrimi i ankesës.

TABELA E DËNIMEVE

Neni	ORGANIZIMI I NDESHJES	Shuma e dënimit
12.1	Mungesa e mjekut kujdestar	300 euro
12.2	Mungesa e pjesëtarëve të sigurisë	200 euro
12.3	Organizimi i dobët i tavolinës zyrtare	100 euro
12.4	Pengimi i punës së tavolinës zyrtare	200 euro
12.5	Mos paraqitja e lojtarëve me uniformë të njëjtë	200 euro
12.6	Mungesa apo aparateve teknike jo të rregullt	200 euro
12.7	Mungesa apo mos funksionimi i LED ndriçimit në tabelën e konstruksionit	300 euro
12.8	Mungesa apo aparatura jo e rregullt e zërimit	150 euro
12.9	Organizimi i dobët në tërësi sipas raportit të ndeshjes	300 euro
12.10	Mos sigurimi i PC për përpilimin e raportit të ndeshjes	150 euro
ORGANIZIMI I DOBËT -SJELLJET E SHIKUESVE		
13.1	Konsumimi i duhanit në palestër	200 euro
13.2	Hedhjet e gjëseneve të buta në terren	100 euro
13.3	Hedhja e gjëseneve të forta (shishe plastike, çakmak, lapsa, para metali)	500 euro
13.4	Animi josportiv i shikuesve ndaj gjyqtarëve, lojtarëve, ekipit mik dhe personave zyrtar.	200 euro
13.5	Animi josportiv i shikuesve ndaj institucionit të Ligës Unike	300 euro
13.6	Animi dhe sjelljet josportive të shikuesve me ofendime fetare, racore si dhe hapja e transparenteve me ofendime nacionale	2.000 euro
13.7	Hedhja në fushë e petardëve, fishekzjarrëve dhe mjeteve tjera piroteknike të cilat shkaktojnë dukshmëri të dobët.	500 euro
13.8	Nëse animi josportiv vazhdon dhe ndërprerja për largimin e shikuesve 15 minutave nuk mund të ndodhë, ndeshja ndërpritet dhe vazhdon brenda 24 orëve.	2.000 euro

13.9	Nëse është realizuar sulmi fizik ndaj personave zyrtarë para-gjatë ndeshjes dhe ndeshja është ndërprerë para skadimit të kohës së ndeshjes.	4.000 euro
Në rast të përsëritjes dënimet do të dyfishohen		
Lojtarët, trajnerët , ndihmës trajnerët , personat zyrtarë		
14.1	Gabimi teknik i lojtarit (sjellje josportive) GT i lojtarit për aktrim nuk është dënim mandatar, por vetëm evidentohet	100 euro
14.2	Gabim teknik i trajnerit	150 euro
14.3	Gabim diskualifikues i lojtarit	400 euro
14.4	Gabim diskualifikues i trajnerit-ndihmës trajnerit.	400 euro
14.5	Sjelljet josportive me tentim sulmit ndaj gjyqtarëve, lojtarëve, trajnerëve, personave zyrtarë para, gjatë dhe pas ndeshjes.	1.000 euro 2 ndeshje
14.6	Realizimi i sulmit fizik ndaj gjyqtarëve, lojtarëve, trajnerëve, personave zyrtarë para, gjatë dhe pas ndeshjes.	4.000 euro Suspendim përjetë
Marketingu i Ligës Unike		
15.1	Mosrespektimi i dispozitave të marrëveshjes të nënshkruar nga Bordi me sponsorët.	1.500 euro
Gjyqtarët		
16.1	Kryerja e papërgjegjshme e detyrës mos respektimi i Rregullores së Garave dhe rregullave të basketbollit.	4 ndeshje
16.2	Mos paraqitja me kohë në ndeshje (75 min) 15 min 30 min	1 ndeshje 2 ndeshje
16.3	Abstenimi pa arsye nga ndeshja e nominuar	Largim nga lista
16.4	Ndarja jo e mirë e drejtësisë sipas raportit të vlerësuesit të gjyqtarëve apo sipas xhirimit të ndeshjes.	2 ndeshje
16.5	Bërja e gabimit material pa ndikim në rezultatin përfundimtar, sipas raportit të vlerësuesit të gjyqtarëve apo xhirimit të ndeshjes	4 ndeshje
16.6	Bërja e gabimit material me ndikim në rezultatin përfundimtar të ndeshjes, sipas raportit të vlerësuesit të gjyqtarëve apo xhirimit të ndeshjes	8 ndeshje
Vëzhguesi		
17.1	Paraqitja jo objektive e fakteve në raport dhe fshehja e fakteve	2 ndeshje
17.2	Dorëzimi jo me kohë i raportit të ndeshjes	2 ndeshje
17.3	Kritikimi publikisht i vendimeve të shqiptuara nga Bordi i Ligës Unike dhe punën e Drejtorit i Ligës/Komesarit të Garave.	Largim nga lista

Neni 18: Ankesat

18.1 Komesari i Garave shqipton të gjitha dënimet në shkallën e parë për shkeljet e përcaktuara nga këto Rregullore të Garave.

18.2 Ankesa e cila nuk është paraqitur me nënshkrimin e kapitenit të ekipit, nuk i është dorëzuar me kohë vëzhguesit të ndeshjes dhe nuk është bërë deponimi i shumës prej 1.000

në afatin e caktuar (15 minuta pas përfundimit të ndeshjes) do të refuzohet dhe nuk do të merret parasysh.

18.3 Komesari i Garave mund të marrë vendim për miratimin e ankesës apo refuzimin e saj.

18.4 Nëse ankesa refuzohet Komesari i Garave do të regjistrojë ndeshjen me rezultatin e arritur.

18.5 Nëse klubet nuk janë dakord me dënimin e shqiptuar nga Komesari i Garave mund t'i drejtohen shkallës së dytë të Bordit Drejtues për rishqyrtimin e dënimit, pas 24 orëve me marrjen e vendimit nga Komesari i Garave.

18.6 Shkalla e II shqyrton ankesën brenda 48 orëve pas pranimit të ankesës, pasi që klubi ka paguar shumën prej 1.500 euro.

18.7 Komesari i Garave mund të shqiptojë dënime (në bazë të xhirimit të ndeshjes ose prezencës së tij në ndeshje) edhe nëse ato nuk janë paraqitur në raportin e ndeshjes nga vëzhguesi i ndeshjes.

18.8 Gjatë Play-Off-it, pas ankesës së dorëzuar të ekipit, në ftesë të Komesarit të Garave, shkalla e II mblidhet dhe menjëherë merr vendim për ankesën e dorëzuar.

Vërejtje:

Të gjitha rastet të cilat nuk janë paraparë, apo nuk janë përfshirë në këtë Rregullore të Garave, Komesari i Garave i zgjedh me zbatimin e akteve të përgjithshme të Federatës Ndërkombëtare të Basketbollit FIBA-së.

Neni 19: Forca Madhore

Neni 19.1 Në raste të shfaqjes së fuqisë madhore, përfshirë mes tjerash fatkeqësitë natyrore, epidemitë dhe pandemitë, gjendjen e jashtëzakonshme të shprehur apo të nënkuptuar, si dhe çfarëdo situatë të ngjashme që rezulton me nevojën për të ndërprerë garat, Bordi Drejtues i Ligës UNIKE mund të bëjë ndryshimin emergjent të Rregullores së Garave dhe sistemit të garave, duke interpretuar situatën e krijuar dhe vendosur në baza meritore për pezullimin, ndërprerjen e plotë, ndërprerjen e pjesërishtme, ri programimin e garave, anulimin e tërësishëm të edicionit, apo ri përcaktimin e kalendarit të garave apo termineve të zhvillimit të ndeshjeve, përfshirë edhe marrjen e vendimit për shpalljen e renditjes tabelare përfundimtare dhe ngritjen apo rënien nga niveli i garës.

Neni 20: Miratimi dhe plotësimi i Rregullores së Garave

Neni 20.1 Rregulloren e Garave e miraton Bordi Drejtues në propozim të Komesarit të Garave.

20.2 Ndërrimet dhe plotësimet e kësaj Rregullore të Garave miratohen sipas procedurës së njëjtë të aprovimit të tyre.

20.3 Interpretimin e Rregullores së Garave e jep Bordi Drejtues në mënyrë direkte.

20.4 Bordi Drejtues e autorizon dhe obligon Komisararin e Garave të Ligës Unike që të përpunojë dhe të jep tekstin e konsoliduar të Rregullores së Garave.

20.5 Kjo Rregullore e Garave hyn në fuqi me miratimin e tyre nga ana e Bordit Drejtues dhe do të zbatohet për edicionin garues 2022/2023.

Miratuar më 03.10.2022

Në emër të Bordit Drejtues të Ligës Unike,

Ilir TREBICKA
Kryetar

LIGA UNIKE